



BASHKIMI EVROPIAN

DELEGACIONI I BASHKIMIT EVROPIAN

Shkup, 27 shtator 2012

**Evenimenti përmbyllës i projektit të financuar nga BE-
ja:**

**"Ndihma teknike për ndërtimin e kapaciteteve të
Byrosë së Metrologjisë"**

Qendra Informative e BE-së

**Fjalim nga
Ekselenca e tij, z. Aivo Orav
Shef i Delegacionit të BE-së**

I nderuari Ministër, z. Saraçini,
I nderuari drejtor, z. Parnargiçev,
Të nderuar zj. Vukovac, z. Perisi,

Zonja dhe Zotërinj,

Ju dëshiroj mirëseardhje në shënimin e përmbylljes së suksesshme të projektit "Ndihma teknike për ndërtimin e kapaciteteve të Byrosë së Metrologjisë".

Ky projekt përfaqëson edhe një hap plotësues drejt harmonizimit të mëtejshëm të legjislacionit të vendit me politikat dhe standardet e BE-së në fushën e lëvizjes së lirë të mallërave.

Një infrastrukturë nacionale, efikase dhe e qëndrueshme e cilësisë – e cila punon sipas standardeve dhe kërkesave evropiane – është parakusht kryesor për lëvizjen e lirë të mallërave përtej kufijve shtetërorë.

Në këtë aspekt, roli i shifrave të metrologjisë është jashtëzakonisht me rëndësi.

Matjet mbështesin praktikisht çdo aspekt të jetës sonë të përditshme, duke ndihmuar të sigurohet cilësia dhe siguria, duke

na mbajtur të shëndetshëm dhe duke na ndihmuar ta përtërijmë ekonominë tonë për ta mbajtur atë konkurruese.

Të dhënat e sakta, të bazuara në matje të besueshme, formojnë gurthemelin e provave të nevojshme për politikëbërjen dhe rregullativat e suksesshme. Të gjitha qeveritë, në shtetet e përparuara teknologjike ashtu si në vendet më pak të zhvilluara, përkrahin infrastrukturën e matjes, për shkak të beneficioneve që i sjell ajo.

Prandaj, Bashkimi Evropian mbështeti projektin që forcoi edhe më shumë kapacitetin e Byrosë së Metrologjisë.

Synimet kryesore të kësaj kontrate për ndihmë teknike ishin:

- këmbimi dhe implementimi i legjislacionit të harmonizuar në fushën e metrologjisë dhe para-paketimeve;
- ofrimi i shërbimeve me cilësi të lartë për komunitetin afarist, konsumatorët dhe qytetarët.

Brenda 21 muajve të zbatimit të projektit, në ekip ekspertësh kryesisht nga institutet metrologjike të Shteteve Anëtare të BE-së, punuan së bashku me stafin e Byrosë, në mënyrë që të përmirësonin edhe më tej cilësinë e metrologjisë në vend.

Dëshiroj të theksoj një zhvillim të rëndësishëm që u arrit gjatë implementimit të projektit. Ekspertët përkrahën Byronë e Metrologjisë në kërkesën për akreditim nacional për katër laboratorët e vet të kalibrimit. Lidhur me Marrëveshjen Multilateral të Akreditimit Evropian, të nënshkruar pak kohë më parë, çertifikatat e kalibrimit të dhëna nga këto laboratore, tani do të njihen plotësisht nga autoritetet përkatëse të shteteve anëtare të BE-së. Reduktimi i një barriere të tillë tregtare për eksportin e mallërave në tregun e BE-së, hap perspektiva të reja për ndërmarrjet lokale.

Në të ardhmen, BE-ja do të vazhdojë bashkëpunimin e vet të ngushtë me qeverinë në këtë fushë, sepse kemi synim të vendosur për t'i ndihmuar vendit në rrugën drejt integritetit në BE.

Ju faleminderit për vëmendjen.